



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 908/5 prot.

Datë 15/06/2021

V E N D I M
Nr. 283/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.06.2021 shqyrtoi kërkesën me:

- Objekt:** Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-96241-05-24-2021, me objekt “Blerje Kancelari”, me fond limit 1.488.745,31 lekë, parashikuar për tu zhvilluar në datën 07.06.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Tiranë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK Autostrada Tiranë-Durrës, km 10, Kashar, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Rruga “Barrikadave”, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.05.2021, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-96241-05-24-2021, me objekt “Blerje Kancelari”, me fond limit 1.488.745,31 lekë, parashikuar për tu zhvilluar në datën 07.06.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Tiranë.

II.2. Në datën 27.05.2021, operatori ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të

plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën nr. 654/6 prot datë 31.05.2021 protokolluar me tonën me nr. 908/2 datë 01.06.2021, autoriteti kontraktor ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr. 654/5 prot, datë 31.05.2021 drejtuar operatorit ekonomik ankimues ku e njofton se me vendimin e datës 31.05.2021 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës të autoritetit kontraktor, pretendimet e ankimuesit nuk janë pranuar, ndërkohë që nuk ka paraqitur informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të dokumenteve standarde të tenderit, si dhe procesi i hartimit dhe miratimit të kriterëve të veçanta për kualifikim.

II.5. Me anë të shkresës nr. 908/3 prot., datë 04.06.2021, Komisioni i Prokurimit Publik ka kërkuar informacion të hollësishëm nga autoriteti kontraktor mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të dokumenteve standarde të tenderit, si dhe procesi i hartimit dhe miratimit të kriterëve të veçanta për kualifikim..

II.6. Me shkresën nr. 654 prot datë 08.06.2021 protokolluar me tonën me nr. 908/4, datë 09.06.2021, autoriteti kontraktor ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.7. Nga shqyrtimi i informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se, ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “*Marketing & Distribution*” SHPK, si dhe i ka kthyer përgjigje ankimuesit me anë të shkresës nr.654/5 prot, datë 31.05.2021, duke mos e pranuar ankesën.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “*Marketing & Distribution*” SHPK ku kërkon: “modifikimin e kriterit të veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.12 për kapacitetin teknik duke pretenduar se kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e mostrave për artikujt (52 artikuj) që kërkohen të prokurohen është një kërkesë e ekzagjeruar dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit, si dhe kjo kërkesë është diskriminuese dhe penguese dhe nuk është në përputhje me natyrën e kontratës që do të

prokurohet, si dhe jo i lidhur ngushtë me aftësinë e zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik dhe për më tepër është i panevojshëm për të zbatuar kontratën.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta për kualifikim”, pika 2.3.12 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.12. Ditën e hapjes së tenderit, Operatorët ekonomikë konkurrues duhet të paraqesin një mostër sipas specifikimeve teknike të Autoritetit Kontraktor për të gjithë artikujt objekt prokurimi.

III.1.2. Në shtojcën 9 “Specifikimet teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar listën e artikujve objekt prokurimi, si dhe specifikimet e tyre kriteri si më poshtë:

Shtojca 9

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj.:

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Nr.	Emërtimi i artikullit	Njësia	Specifikime teknike
1	Dosje me llastik	Copë	Dosje kartoni me luster, me llastik. Përmasat 23x34x1cm.
2	Dosje me lidhëse	Copë	Dosje kartoni me lidhëse, me mbështjellëse anësore shtesë nga të tria anët. Përmasat Gjer.22 cm, Gjat. 33cm, Trash. 12 cm,
3	Dosje me mekanizëm	Copë	Dosje me mekanizëm dhe kuti 8cm
4	Bllok fletë- hyrje	Copë	Vetekopjuese 3 kopje (numri i fleteve 33x3=99)
5	Bllok fletë- dalje	Copë	Vetekopjuese 3 kopje (numri i fleteve 33x3=99)
6	Bllok urdhër-dorëzimi	Copë	Vetekopjues 2 kopje. Numri i fleteve 50x2=100. Përmasat 14cm x 10cm, me

			kapake kartoni
7	Lapsa plumbi me gomë	Cope	Lapsa druri HB me majë plumbi me gomë. Të jenë te dizenuar me dru të vërtetë dhe të mprehin lehtë. Nuk duhet të gërvishtin letrën dhe të jenë shumë komfort në përdorim.
8	Evidenziator (lapustin shenjues)	Cope	I trashë cilësor, me ngjyra të ndryshme. Trashësia e shënimit 5 mm
9	Bllok i verdhë	Cope	Permasat 76x76x100 flete
10	Tela aktesh nr. 3	Pako	Nr. 3/ 100 cope-pakoja
11	Heqëse kapësesh teli	Cope	Metalike në forme pinçe
12	Letër A4	Pako	Cilesore 80 gr e bardhë.(pako 500 flete).Letra të jetë 100% bardhësi, 100% puple druri. Të vertetohet me certifikate perkatesie të cilesise nga kompania.
13	Liber magazine	Cope	200 flete + kapak kartoni i trashë 600 gr/m2 . Permasat 17x24 cm (±1 cm)
14	Libër protokoli	Cope	100 flete, me kopertinë kartoni të trashë 600 gr/m2. Permasat 24 x 34 cm
15	Regjistër prezence	Cope	100 flete, me kopertinë kartoni të trashë 600 gr/m2. Permasat 24 x 34 cm
16	Fletore për aktivitetin ditor të Psikologut dhe Punonjësit Social	Cope	100 fletë (200 faqe). Të jetë i realizuar me “Lidhje libri” me ngjitje ose me lidhje (me pe) dhe jo me papercod. Kapaku i librit duhet të jetë karton 350-400 gr/m2, me ngjyrë të bardhë, me logon dhe emërtimin e institucionit. Faqet e brendshme me ngjyrë të bardhë. Modeli i saktë i logos, emërtimi i institucionit dhe shkrimet e tjera do të tërhiqen nga OE fitues. Në pjesën e brendshme të kapakut do të shkruhet modeli i dokumentit sipas përcaktimit të institucionit. Modeli i kopertinës do të jetë me 4 ngjyra, kurse faqet e brendshme me një ngjyrë (e zezë) Permasat: Formati A4.
17	Fletore për fëmijët me nevoja të veçanta	Cope	100 fletë (200 faqe). Të jetë i realizuar me “Lidhje libri” me ngjitje ose me lidhje (me pe) dhe jo me papercod. Kapaku i librit duhet të jetë karton 350-400 gr/m2, me ngjyrë të bardhë, me logon dhe

			<p>emërtimin e institucionit.</p> <p>Faqet e brendshme me ngjyrë të bardhë. Modeli i saktë i logos, emërtimi i institucionit dhe shkrimet e tjera do të tërhiqen nga OE fitues.</p> <p>Në pjesën e brendshme të kapakut do të shkruhet modeli i dokumentit sipas përcaktimit të institucionit. Modeli i kopertinës do të jetë me 4 ngjyra, kurse faqet e brendshme me një ngjyrë (e zezë)</p> <p>Përmasat: Formati A4.</p>
18	Fletore për takimet me prindër dhe trajnimin e stafit edukator	Copë	<p>100 fletë (200 faqe).</p> <p>Të jetë i realizuar me “Lidhje libri” me ngjitje ose me lidhje (me pe) dhe jo me papercod. Kapaku i librit duhet të jetë karton 350-400 gr/m2, me ngjyrë të bardhë, me logon dhe emërtimin e institucionit.</p> <p>Faqet e brendshme me ngjyrë të bardhë. Modeli i saktë i logos, emërtimi i institucionit dhe shkrimet e tjera do të tërhiqen nga OE fitues.</p> <p>Në pjesën e brendshme të kapakut do të shkruhet modeli i dokumentit sipas përcaktimit të institucionit. Modeli i kopertinës do të jetë me 4 ngjyra, kurse faqet e brendshme me një ngjyrë (e zezë)</p> <p>Përmasat: Formati A4.</p>
19	Dosje personale e fëmijës	Copë	<p>6 fletë (12 faqe).</p> <p>Të jetë i realizuar me lidhje (me pe) Kapaku i librit duhet të jetë karton me llustër 350-400 gr/m2, me ngjyrë të bardhë, me logon dhe emërtimin e institucionit.</p> <p>Faqet e brendshme me ngjyrë të bardhë. Modeli i saktë i logos, emërtimi i institucionit dhe shkrimet e tjera do të tërhiqen nga OE fitues.</p> <p>Në pjesën e brendshme të kapakut do të shkruhet modeli i dokumentit sipas përcaktimit të institucionit.</p>

			Modeli i kopertinës do të jetë me 4 ngjyra, kurse faqet e brendshme me një ngjyrë (e zezë) Përmasat: Formati A4.
20	Qese dokumentash	Pako	Formati A4. Trashësia 100 micron. Paketimi 100 fije/pako
21	Zarfa të vegjël	Cope	Permasa 11x23 cm
22	Zarfa të mesëm	Cope	Permasa 19 x 25.5 cm
23	Zarfa të medhenj	Cope	Permasa 23 x 32 cm
24	Makinë kapëse nr. 24/6	Cope	Nr. 24/6. Me forme gershere. Metalike. Hapje me rrotullim per mbushjen e indikatorit.
25	Makinë kapëse nr. 10	Cope	Nr. 10. Me forme gershere. Metalike. Hapje me rrotullim per mbushjen e indikatorit.
26	Makine per kapje dok e madhe. Kapacitet jo me pak se 240 flete.	Cope	Per qepje dokumentash, e gjitha prej metali. Kapacitet jo me pak se 240 flete.
27	Tela makine nr. 10	Pako	Nr. 10
28	Tela makine nr. 24/6	Pako	Nr. 24/6
29	Tela makine 23/10 (40-70 faqe)	Pako	Nr 23/10
30	Tela makine 23/13 (70-100 faqe)	Pako	Nr 23/13
31	Tela makine 23/15 (100-140 faqe)	Pako	Nr 23/25
32	Tela makine 23/20 (140-200)	Pako	Nr 23/20
33	Tela makine 23/24 (200-240)	Pako	Nr 23/24
34	Korrektor	Cope	Forme stilolapsi. Madhësia 7 ml. Trashësia e majës 0.8 mm
35	Goma	Cope	Goma per fshirje lapsi
36	Vizore 30 cm	Cope	Plastike 30 cm
37	Makinë llogaritëse	Cope	E madhe per zyre 16 digits
38	CD të reja boshe	Cope	CD të reja boshe me paketim me kapak te personalizuar
39	Stilolapsa te kuq	Cope	Stilolapsa cilesore për shkrim të përgjithshëm. Trashësia e majës 0.7 mm- 0.9 mm (jo me sustë)
40	Stilolapsa blu	Cope	Stilolapsa cilesore për shkrim të përgjithshëm. Trashësia e majës 0.7 mm- 0.9 mm (jo me sustë)
41	Ngjitës stik	Cope	Me formë të rrumbullakët. Me peshë jo më pak se 35 gr. Me datë skadence jo më parë se viti 2022.
42	Letra shenjuese (neon indikator)	Cope	Material plastik me 5 ngjyra

43	Boje per Printer/ skaner/ fotokopje Xerox Copier ëorkcenter 5335	Cope	Part Number 006R01160/ ose ekuivalente rajonale
44	Boje per Printer/ skaner/ fotokopje Xerox Copier Versalink B 7030	Cope	Part Number 106R03395/ ose ekuivalente rajonale
45	Bojë për Printer/ skaner/ fotokopje Lexmark MX310 dn	Cope	Part Number 60F2000/ ose ekuivalente rajonale
46	Bojë për Printer/ skaner/ fotokopje Lexmark MX317 dn	Cope	Part Number 51B2000 ose ekuivalente rajonale
47	Boje per tampon vule	Cope	Bojë për tampon vule me ngjyrë blu
48	Binder Clip (51 mm, metal) (12 copë për pako)	Pako	Metal - 12 copë për pako 51 mm
49	Binder Clip (41 mm, metal) (12 copë për pako)	Pako	Metal - 12 copë për pako 41 mm
50	Binder Clip (25 mm, metal) (12 copë për pako)	Pako	Metal - 12 copë për pako 25 mm
51	Kapake transparentë për lidhje dokumentash - Laster A4 (me ngjyra të ndryshme)	Cope	Kapakë transparentë për lidhje dokumentash - Laster (plastik) A4 (me ngjyra të ndryshme)
52	Ullukë plastikë për lidhje dokumentash 6 mm (me ngjyra të ndryshme)	Cope	Ullukë plastikë për lidhje dokumentash 6 mm (me ngjyra të ndryshme)

Argumentim:

Për hartimin e specifikimeve teknike komisioni iu është referuar kërkesave të institucionit për llojin, tipin, përmasat dhe të dhënat teknike specifike të secilit artikull që kërkohet.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

III.1.3. Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.1.4. Në nenin 134, pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, që nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji. Çdo akt tjetër nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.”.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik i referohet Vendimit nr.914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, për aq sa ky i fundit nuk bie në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Konkretisht, në nenin 27 pika 6 “a”, të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit dhe/ose

Komisioni gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

III.1.5. Në lidhje me pretendimin më sipër të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterit të veçantë të kualifikimit të sipërpërmendur, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77, pika 1, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”. Në rastin konkret K.P.P. konstaton se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. KPP konstaton se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kriteret kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kriteret e tjera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimin të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave.

Në këto kushte, KPP gjykon se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e mostrave është në përputhje me nenin 27 pika 6 gërma “a” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, por kërkesa për dorëzimin e mostrave për secilin artikull objekt prokurimi, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Komisioni gjykon se, është e mjaftueshme që operatorët ekonomik pjesëmarrës të paraqesin vetëm nga një ekzemplar (mostër) për produktet që do të prokurohen, më përdorueshmëri më të lartë për institucionin, me qëllim verifikimin nëse këto produkte plotësojnë kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e kriterit të sipërcituar sipas konstatimeve të mësipërme.

Sa më sipër, pretendimi e operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK ku kërkon: “Referuar kriterit si më poshtë: “Për letrën format A4, OE duhet të paraqesë Certifikatë Cilësie për plotësimin e specifikimeve të kërkuara.”.

Në lidhje me këtë kriter, ju bëjmë me dije se dokumenti që ju kërkonti nuk lidhet me asnjë dokument real. Duke qenë se jemi një shoqëri që operon në treg nga 20 vite dhe jemi tregtues të 8 lloje të ndryshme letrash, duke pasur korrespondencë të vazhdueshme me prodhuesin. Për këtë arsye ju sqarojmë se ekzistojnë 2 lloje dokumentesh që janë:

1. Skeda teknike e letrës e cila ka të afishuar parametrat që kërkohen për letrën, duke përcaktuar, bardhësinë, lëmueshmërinë, dritën etj. Parametra që ju për artikullin letër nuk i keni specifikuar por e keni lënë evazive.

2. Certifikatë Ekselence që i akordohet PRODHUESIT dhe jo letrës, CERTIFIKATË e cila vërteton që shoqëria në fjale disponon ISO-t, pra ISO-t gjithmonë i referohen shoqërisë dhe jo letrës. Kjo certifikatë është lehtësisht e zëvendësueshme/ ekuivalente me kërkimin e ISO-ve specifike në mënyrë që ky kriter të mos jetë diskriminues për OE specifik.

Nga sqarimet e mësipërme ju lutem bëni ndryshimin e këtij kriteri dhe vendosni se cilin dokument kërkonti, pasi ai dokument që ju kërkonti tani nuk ekziston.

Për kriterin e mëposhtëm:

“Në momentin e dorëzimit të mallit tek autoritetet kontraktore , malli të shoqërohet:

- Fletë garanci për produktet e paraqitura, ku të jenë përcaktuar detyrimet e OE dhe përgjegjësia e tij për tonerët e lëvruar që nga momenti i lëvrimin e deri në momentin kur boja vendoset ne printerin/fotokopjen për të cilën ajo është kërkuar.*
- Certifikatën e cilësisë.*
- Certifikatën e origjinës.”*

Ju bëjmë me dije se kriteri i mësipërm është objektivisht i pamundur të realizohet. Nga shoqëritë prodhuese nuk merret nga një certifikatë cilësie dhe origjine për çdo artikull që ato prodhojnë.

Gjithashtu për aq kohë sa kriteret në bazë të nenit 77 të ligjit të prokurimeve duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit dhe jo diskriminuese dhe kufizuese, ju bëjmë me dije se ky kriter është i tillë. Për aq kohë sa OE zotohet ligjërisht në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale eventuale, ky kriter duket qartazi se nuk është në përputhje me parashikimet ligjore.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta për kualifikim”, pika 2.3.10 dhe 2.3.11 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohen kriteret si më poshtë:

2.3.10. Në momentin e dorëzimit te mallit tek autoritetet kontraktore , malli te shoqërohet :

- Fletë garanci për produktet e paraqitura, ku të jenë përcaktuar detyrimet e OE dhe përgjegjësia e tij për tonerët e lëvruar që nga momenti i lëvrimin e deri në momentin kur boja vendoset ne printerin/fotokopjen për të cilën ajo është kërkuar.*
- Certifikatën e cilësisë.*
- Certifikatën e origjinës.*

2.3.11. Për letrën format A4, OE duhet të paraqesë Certifikatë cilësie për plotësimin e specifikimeve të kërkuara.

III.2.2. Në shtojcën 9 “Specifikimet teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar listën e artikujve objekt prokurimi, si dhe specifikimet e tyre kriteri si më poshtë:

Shtojca 9

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj.:

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Nr.	Emërtimi i artikullit	Njësia	Specifikime teknike
1	Dosje me llastik	Copë	Dosje kartoni me luster, me llastik. Përmasat 23x34x1cm.
2	Dosje me lidhese	Copë	Dosje kartoni me lidhëse, me mbeshtjellese anësore shtesë nga të tria anët. Përmasat Gjer.22 cm, Gjat. 33cm, Trash. 12 cm,
3	Dosje me mekanizëm	Copë	Dosje me mekanizem dhe kuti 8cm
4	Blllok fletë- hyrje	Copë	Vetekopjuese 3 kopje (numri i fleteve 33x3=99)
5	Blllok fletë- dalje	Copë	Vetekopjuese 3 kopje (numri i fleteve 33x3=99)
6	Blllok urdhër-dorëzimi	Cope	Vetekopjues 2 kopje. Numri i fleteve 50x2=100. Përmasat 14cm x 10cm, me kapake kartoni
7	Lapsa plumbi me gomë	Cope	Lapsa druri HB me majë plumbi me gomë. Të jenë të dizenuar me dru të vërtetë dhe të mprihen lehtë. Nuk duhet të gërvishin letrën dhe të jenë shumë komfort në përdorim.
8	Evidenziator (lapustin shenjues)	Cope	I trashë cilesor, me ngjyra të ndryshme. Trashësia e shënimit 5 mm
9	Blllok i verdhë	Cope	Përmasat 76x76x100 flete
10	Tela aktesh nr. 3	Pako	Nr. 3/ 100 cope-pakoja
11	Heqëse kapësesh teli	Cope	Metalike ne forme pince
12	Letër A4	Pako	Cilesore 80 gr e bardhe.(pako 500 flete).Letra te jete 100% bardhesi, 100% puple druri. Te vertetohet me certificate perkatesie te cilesise nga kompania.
13	Liber magazine	Cope	200 flete + kapak kartoni i trashë 600 gr/m2 . Përmasat 17x24 cm (±1 cm)
14	Libër protokolli	Cope	100 flete, me kopertinë kartoni të trashë 600 gr/m2. Përmasat 24 x 34 cm
15	Regjistër prezence	Cope	100 flete, me kopertinë kartoni të trashë 600 gr/m2. Përmasat 24 x 34 cm
16	Fletore për aktivitetin ditor të Psikologut dhe Punonjësit Social	Cope	100 fletë (200 faqe). Të jetë i realizuar me “Lidhje libri” me ngjitje ose me lidhje (me pe) dhe jo me papercod.

			<p>Kapaku i librit duhet të jetë karton 350-400 gr/m², me ngjyrë të bardhë, me logon dhe emërtimin e institucionit.</p> <p>Faqet e brendshme me ngjyrë të bardhë.</p> <p>Modeli i saktë i logos, emërtimi i institucionit dhe shkrimet e tjera do të tërhiqen nga OE fitues.</p> <p>Në pjesën e brendshme të kapakut do të shkruhet modeli i dokumentit sipas përcaktimit të institucionit.</p> <p>Modeli i kopertinës do të jetë me 4 ngjyra, kurse faqet e brendshme me një ngjyrë (e zezë)</p> <p>Përmasat: Formati A4.</p>
17	Fletore për fëmijët me nevoja të veçanta	Cope	<p>100 fletë (200 faqe).</p> <p>Të jetë i realizuar me “Lidhje libri” me ngjitje ose me lidhje (me pe) dhe jo me papercod.</p> <p>Kapaku i librit duhet të jetë karton 350-400 gr/m², me ngjyrë të bardhë, me logon dhe emërtimin e institucionit.</p> <p>Faqet e brendshme me ngjyrë të bardhë.</p> <p>Modeli i saktë i logos, emërtimi i institucionit dhe shkrimet e tjera do të tërhiqen nga OE fitues.</p> <p>Në pjesën e brendshme të kapakut do të shkruhet modeli i dokumentit sipas përcaktimit të institucionit.</p> <p>Modeli i kopertinës do të jetë me 4 ngjyra, kurse faqet e brendshme me një ngjyrë (e zezë)</p> <p>Përmasat: Formati A4.</p>
18	Fletore për takimet me prindër dhe trajnimin e stafit edukator	Copë	<p>100 fletë (200 faqe).</p> <p>Të jetë i realizuar me “Lidhje libri” me ngjitje ose me lidhje (me pe) dhe jo me papercod.</p> <p>Kapaku i librit duhet të jetë karton 350-400 gr/m², me ngjyrë të bardhë, me logon dhe emërtimin e institucionit.</p> <p>Faqet e brendshme me ngjyrë të bardhë.</p> <p>Modeli i saktë i logos, emërtimi i institucionit dhe shkrimet e tjera do të tërhiqen nga OE fitues.</p> <p>Në pjesën e brendshme të kapakut do të shkruhet modeli i dokumentit sipas përcaktimit të institucionit.</p>

			Modeli i kopertinës do të jetë me 4 ngjyra, kurse faqet e brendshme me një ngjyrë (e zezë) Përmasat: Formati A4.
19	Dosje personale e fëmijës	Cope	6 fletë (12 faqe). Të jetë i realizuar me lidhje (me pe) Kapaku i librit duhet të jetë karton me llustër 350-400 gr/m2, me ngjyrë të bardhë, me logon dhe emërtimin e institucionit. Faqet e brendshme me ngjyrë të bardhë. Modeli i saktë i logos, emërtimi i institucionit dhe shkrimet e tjera do të tërhiqen nga OE fitues. Në pjesën e brendshme të kapakut do të shkruhet modeli i dokumentit sipas përcaktimit të institucionit. Modeli i kopertinës do të jetë me 4 ngjyra, kurse faqet e brendshme me një ngjyrë (e zezë) Përmasat: Formati A4.
20	Qese dokumentash	Pako	Formati A4. Trashësia 100 micron. Paketimi 100 fije/pako
21	Zarfa të vegjël	Cope	Permase 11x23 cm
22	Zarfa të mesëm	Cope	Permase 19 x 25.5 cm
23	Zarfa të medhenj	Cope	Permase 23 x 32 cm
24	Makinë kapëse nr. 24/6	Cope	Nr. 24/6. Me forme gershere. Metalike. Hapje me rrotullim për mbushjen e indikatorit.
25	Makinë kapëse nr. 10	Cope	Nr. 10. Me forme gershere. Metalike. Hapje me rrotullim për mbushjen e indikatorit.
26	Makine për kapje dok e madhe. Kapacitet jo më pak se 240 flete.	Cope	Për qepje dokumentash, e gjitha prej metali. Kapacitet jo më pak se 240 flete.
27	Tela makine nr. 10	Pako	Nr. 10
28	Tela makine nr. 24/6	Pako	Nr. 24/6
29	Tela makine 23/10 (40-70 faqe)	Pako	Nr 23/10
30	Tela makine 23/13 (70-100 faqe)	Pako	Nr 23/13
31	Tela makine 23/15 (100-140 faqe)	Pako	Nr 23/25
32	Tela makine 23/20 (140-200)	Pako	Nr 23/20
33	Tela makine 23/24 (200-240)	Pako	Nr 23/24
34	Korrektor	Cope	Forme stilolapsi. Madhësia 7 ml. Trashësia e majës 0.8 mm

35	Goma	Cope	Goma per fshirje lapsi
36	Vizore 30 cm	Cope	Plastike 30 cm
37	Makinë llogaritëse	Cope	E madhe per zyre 16 digits
38	CD të reja boshe	Cope	CD të reja boshe me paketim me kapak te personalizuar
39	Stilolapsa te kuq	Cope	Stilolapsa cilesore për shkrim të përgjithshëm. Trashësia e majës 0.7 mm- 0.9 mm (jo me sustë)
40	Stilolapsa blu	Cope	Stilolapsa cilesore për shkrim të përgjithshëm. Trashësia e majës 0.7 mm- 0.9 mm (jo me sustë)
41	Ngjitës stik	Cope	Me formë të rrumbullakët. Me peshë jo më pak se 35 gr. Me datë skadence jo më parë se viti 2022.
42	Letra shenjuese (neon indikator)	Cope	Material plastik me 5 ngjyra
43	Boje per Printer/ skaner/ fotokopje Xerox Copier ëorkcenter 5335	Cope	Part Number 006R01160/ ose ekuivalente rajonale
44	Boje per Printer/ skaner/ fotokopje Xerox Copier Versalink B 7030	Cope	Part Number 106R03395/ ose ekuivalente rajonale
45	Bojë për Printer/ skaner/ fotokopje Lexmark MX310 dn	Cope	Part Number 60F2000/ ose ekuivalente rajonale
46	Bojë për Printer/ skaner/ fotokopje Lexmark MX317 dn	Cope	Part Number 51B2000 ose ekuivalente rajonale
47	Boje per tampon vule	Cope	Bojë për tampon vule me ngjyrë blu
48	Binder Clip (51 mm, metal) (12 copë për pako)	Pako	Metal - 12 copë për pako 51 mm
49	Binder Clip (41 mm, metal) (12 copë për pako)	Pako	Metal - 12 copë për pako 41 mm
50	Binder Clip (25 mm, metal) (12 copë për pako)	Pako	Metal - 12 copë për pako 25 mm
51	Kapake transparentë për lidhje dokumentash - Laster A4 (me ngjyra të ndryshme)	Cope	Kapakë transparentë për lidhje dokumentash - Laster (plastik) A4 (me ngjyra të ndryshme)
52	Ullukë plastikë për lidhje dokumentash 6 mm (me ngjyra të ndryshme)	Cope	Ullukë plastikë për lidhje dokumentash 6 mm (me ngjyra të ndryshme)

Argumentim:

Për hartimin e specifikimeve teknike komisioni iu është referuar kërkesave të institucionit për llojin, tipin, përmasat dhe të dhënat teknike specifike të secilit artikull që kërkohet.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

III.2.3. Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.2.4. Në nenin 134, pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, që nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji. Çdo akt tjetër nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.”.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik i referohet Vendimit nr.914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, për aq sa ky i fundit nuk bie në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Konkretisht, në nenin 27 pika 1, të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Specifikimet teknike duhet të

përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.“.

Gjithashtu në nenin 61, pika 2, të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.*

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit. “.

III.2.5. Lidhur me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK, autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes nr. 654 prot, datë 31.05.2021 drejtuar ankimuesit ka argumentuar se: *“Sqarojmë se, referuar listës së dokumenteve të lëshuara nga një prodhues, për produktin e prodhuar nga ana e tij, të cilat mund të jenë, Certifikatë cilësie, Skedë teknike, Skedë Sigurie, Certifikatë Konformiteti etj., nga ana e AK është kërkuar minimalisht "Certifikata e Cilësisë", ku të jenë përcaktuar parametrat e kërkuara, pasi këto parametra janë kryesisht cilësore dhe jo thjeshtë teknike. Gjithashtu sqarojmë se, ky dokument sigurohet lehtësisht dhe pa kosto, pasi, ky është produkt importi dhe në procedurat e zhdoganimit, malli duhet të shoqërohet me këtë dokument.”,* ndërkohë që referuar Procesverbalit nr. 603/29 prot, datë 24.05.2021, të mbajtur nga specialisti i fushës lidhur më hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, ku është përcaktuar si në vijim: *“ 3. Kriteret teknike të kualifikimit. Për të garantuar cilësinë e produkteve të kërkuara, operatori ekonomik duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:*

Në momentin e dorëzimit të mallit tek autoritetet kontraktore , malli të shoqërohet :

- Fletë garanci për produktet e paraqitura, ku të jenë përcaktuar detyrimet e OE dhe përgjegjësia e tij për tonerët e lëvruar që nga momenti i lëvrimin e deri në momentin kur boja vendoset në printerin/fotokopjen për të cilën ajo është kërkuar.

- Certifikatën e cilësisë.

- Certifikatën e origjinës.

Për letrën format A4, OE duhet të paraqesë Certifikatë cilësie për plotësimin e specifikimeve të kërkuara.

Argumentim:

Kërkesa që OE duhet të paraqesë Certifikatën e Cilësisë për letrën Format A4 i shërben verifikimit nga ana e komisionit, të kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike për këtë produkt.”, duke mos argumentuar vendosjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.10 të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit, ndërsa argumentimi i kriterit kualifikues të përcaktuar në

pikën 2.3.11 të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit është i ndryshëm nga argumentet e dhëna ankimuesit me shkresën nr. 654 prot, datë 31.05.2021.

III.2.6. Lidhur me pretendimin e autoritetit kontraktor se Certifikata e Cilësisë është dokument i domosdoshëm për zhdoganimin e mallit objekt prokurimi “Letër Format A4”, meqenëse ky artikull është produkt importi, Komisioni i Prokurimit Publik ju referuar VKM nr. 651, datë 10.12.2017 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, dokumente detyruese sipas kushteve për zhdoganimin e mallrave të importit janë Certifikata EURO 1 DHE Certifikata e Origjinës, pra Certifikata e Cilësisë nuk është dokument detyrues.

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik ju referua dhe Ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar nga ku konstatohet se Certifikata e Cilësisë nuk është dokument detyrues për vendosjen në treg të produkteve joushqimore, për të cilat nuk ekziston një kuadër i veçantë ligjor dhe institucional, në mënyrë që të garantojnë dhe të sigurojnë përputhshmërinë e tyre me kërkesat ligjore në lidhje me to.

Në këto kushte, KPP gjykon se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e Certifikatës së Cilësisë nuk është i argumentuar, si dhe nuk justifikohet me shkresën nr. 654 prot, datë 31.05.2021, pasi kuadri ligjor i sipërpërmendur nuk e parashikon si domosdoshmëri dorëzimin e këtij dokumenti, prandaj kriteret kualifikuese të përcaktuara në pikat 2.3.10 dhe 2.3.11 të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit duhet të modifikohen, duke hequr kërkesën për paraqitjen e Certifikatës së Cilësisë.

Ndërsa lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik për Certifikatën e Origjinës, KPP gjykon se është një dokument që e parashikon legjislacioni i sipërpërmendur lidhur me zhdoganimin e mallrave dhe si një dokument i rëndësishëm për përcaktimin e vlerës doganore dhe taksave doganore që aplikohen për vënien e mallit në qarkullim të lirë në treg, duke mos e pranuar këtë pretendim të ankimuesit.

Për sa më sipër pretendimet e ankimuesit qëndrojnë pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK ku kërkon: “Për artikujt “Makinë kapëse nr. 24/6” dhe “Makinë kapëse nr.10” përcaktimi i përmasave, i formës dhe i materialit është mëse i kuptueshëm dhe i përligjur përcaktimi teknik “Hapje me rrotullim për mbushjen e indikatorit” që është një specifikim estetik dhe nuk ndikon në cilësinë dhe efikasitetin e artikullit, këtu na lindin dyshimet, pasi ky specifikim të adreson vetëm tek një prodhues që e prodhon këtë artikull me këto cilësi dhe ky përcaktim të orienton vetëm tek një operator ekonomik që e disponon. Në këto kushte ju lutemi hiqeni këtë përcaktim, pasi është jo në përputhje me legjislacionin në fuqi” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 9 “Specifikimet teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar listën e artikujve objekt prokurimi, si dhe specifikimet e artikujve me numër rendor 24 dhe 25, si më poshtë:

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj.:

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Nr.	Emërtimi i artikullit	Njësia	Specifikime teknike
24	Makinë kapëse nr. 24/6	Cope	Nr. 24/6. Me forme gershere. Metalike. Hapje me rrotullim per mbushjen e indikatorit.
25	Makinë kapëse nr. 10	Cope	Nr. 10. Me forme gershere. Metalike. Hapje me rrotullim per mbushjen e indikatorit.

Argumentim:

Për hartimin e specifikimeve teknike komisioni iu është referuar kërkesave të institucionit për llojin, tipin, përmasat dhe të dhënat teknike specifike të secilit artikull që kërkohet.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

III.3.2. Neni 36 “Specifikimet teknike” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkua ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III.2.3. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përrjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenin 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksional sipas metodës së parë por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas

metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: “Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohen në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat që kërkohet për një punë, shërbim ose furnizim” Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: "specifikim teknik" nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Cëshjta C-368/10 “Komisioni Europian vs. Mberëtëria e Hollandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: “Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”

III.2.4. KPP gjykon se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.2.5. Komisioni i Prokurimit Publik nga shqyrtimi i Procesverbalit nr. 603/23 prot, datë 21.05.2021 i mbajtur nga komisioni i ngritur me Urdhërin nr. 522, datë 21.05.2021 “*Mbi*

hartimin e specifikimeve teknike, testimi të tregut, kriterëve teknike të kualifikimit, grafikut të lëvrimit dhe kushteve të veçanta të kontratës për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje kancelari” për D.P.Ç.K për vitin 2021”, ku argumentimi i dhënë për hartimin e specifikimeve teknike është si në vijim: “Në zbatim të Urdhrin nr. 522, datë 21.05.2021 “Mbi hartimin e specifikimeve teknike, testimi të tregut, kriterëve teknike të kualifikimit, grafikut të lëvrimit dhe kushteve të veçanta të kontratës për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje kancelari” për D.P.Ç.K për vitin 2021”, komisioni duke iu referuar specifikave përkatëse, si dhe natyrës së artikujve të kërkuar, vendosi: Makinë kapëse nr. 24/6 me këto specifikime teknike “Me formë gërshëre. Metalike. Hapje me rrotullim për mbushjen e indikatorit” dhe makinë kapëse nr. 10 me këto specifikime teknike “Me formë gërshëre. Metalike. Hapje me rrotullim për mbushjen e indikatorit”, si dhe referuar kthimin e përgjigjes nr. 654 prot, datë 31.05.2021 drejtuar ankimuesit ka argumentuar se: “Në treg këto artikuj gjenden në forma dhe modele me përmasa nga më të ndryshmet. Referuar cilësive dhe mirëfunktionimit të tyre, si dhe përvojës së mëparshme, AK midis shumë modeleve ka përzgjedhur atë “me hapje me rrotullim për mbushjen e indikatorit.”, gjykon se nga ana e autoritetit kontraktor nuk janë dhënë sqarime në nivel teknik lidhur me mënyrën dhe nevojën e përzgjedhjes përcaktimit të specifikimit teknik “Hapje me rrotullim për mbushjen e indikatorit” për makinat kapëse, duke mos shpjeguar nevojën e këtij institucionit se përse këto artikuj duhet të jenë me këtë specifikim teknik.

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se specifikimi teknik “Hapje me rrotullim për mbushjen e indikatorit” nuk është element i rëndësishëm përbërës i produktit, i cili garanton cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, prandaj autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e specifikimeve teknike, duke e hequr specifikimin teknik “Hapje me rrotullim për mbushjen e indikatorit” për artikujt me numër rendor 24 dhe 25 të Shtojcës 9 të dokumenteve të tenderit.

Për sa më sipër, pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.3.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: “Për artikullin “Letër A4” na duhen shpjegimet e mëposhtëme:

Ju lutem përcaktoni sasinë ekzakte që kërkohet për këtë artikull, pasi e kemi të pamundur të ofertojmë vetëm me këtë përcaktim të bërë nga ana juaj.

Me pako ju nënkuptoni 1 rizëm me 500 fletë?

Apo me pako nënkuptoni një kuti me 5 rizma?

Përsa më sipër mbetemi në pritje të përgjigjes tuaj.”.

III.3.2. Sa më sipër cituar, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit rezulton se autoriteti kontraktor në Shtojcën 9 “Specifikimet teknike” për artikullin “Letër A4” ka përcaktuar specifikimet teknike si në vijim: “Cilësore 80 gr e bardhe.(pako 500 flete)”, pra 1 (një) pako duhet të ketë 500 fletë, ndërkohë që në Shtojcën 10 ‘Sasia dhe grafiku i lëvrimit” është kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor blerja e një sasive prej 1300 pako letër A4.

III.3.3. Për sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se ndodhemi para kërimit të operatorit ekonomik ankimues mbi sqarime në lidhje me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi. KPP-ja gjykon se ashtu si vendosja e kriterëve të kualifikimit edhe hartimi i specifikimeve teknike të cilat duhet të plotësojnë punët, mallrat apo shërbimet objekt prokurimi është në të drejtën e autoritetit kontraktor për sa kohë që respektohen kushtet e qartësisë, proporcionalitetit të tyre me objektin e prokurimit, dhe janë përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. Autoriteti kontraktor në cilësinë e institucionit të specializuar për hartimin e këtyre specifikimeve, në kthimin e përgjigjes nr. 654 prot, datë 31.05.2021 drejtuar ankimesit ka dhënë sqarime për kërkesat e tij, lidhur me sasinë e fletëve që duhet të këtë një pako letër A4, duke sqaruar se: “... referuar Shtojcës 9 të DST, Specifikimet Teknike, konkretisht artikulli 12 i tabelës, Letër A4, ku përcaktohet “Cilësore 80 gr e bardhë (pako 500 fletë) është saktësuar se kërkohet pako me 500 fletë.”.

Në këto kushte KPP-ja gjykon se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 75 të LPP-së i cili parashikon shprehimisht se: “1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit. 2. Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar. 3. Çdo shtojcë për ndryshim të dokumenteve të tenderit komunikohet në të njëjtën mënyrë që është bërë publikimi i njoftimit të procedurës”, duhet të publikojë shtojcën me sqarime në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, me qëllim njohjen e të gjithë operatorëve ekonomikë ankimues me sqarimet për dokumentet e tenderit, për të qenë të qartë e të saktë për të gjithë të interesuarit për këtë procedurë prokurimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 2 e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-96241-05-24-2021, me objekt “Blerje Kancelari”, me fond limit 1.488.745,31 lekë, parashikuar për tu zhvilluar në datën 07.06.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të bëjë modifikimet dhe sqarimet përkatëse të dokumenteve të tenderit në SPE.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri